



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KRYETAR

Nr. 3600 prot.

Vlorë, më 20.02 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ .datë ____ . ____ 2026

“PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE, PËR VITIN 2026 DHE TARIFËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT PËR ZONËN E PLAZHEVE, TË ADMINISTRUARA DHE TË TARIFUAR NGA NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 1 neni 9 pika 1 nënpika 1.1 i ndryshuar, Ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, Ligjit Nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, V.K.M -së Nr.321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujrat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, i ndryshuar, V.K.M -së Nr.845, datë 28.10.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi”, V.K.M-së Nr 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar si dhe në relacionin e paraqitur nga administrata e bashkisë Vlorë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë hartën e përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2026, sipas materialit hartografik bashkëlidhur, i cili përmban:
 - a) Hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari si stacion plazhi.
 - b) Hapësirat e plazhit publik.
 - c) Hapësirën ujore të lejuar për notim, zonë e rrethuar nga bova.
 - d) Vendqëndrimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e levizjes së tyre.
 - e) Hapësirat e plazhit publik të tarifuar nga NJVV-ja.
2. Tarifa për ofrimin e shërbimeve në plazhet publike të jetë deri në 50% të vlerës së tarifave në treg. Vlera e tregut përcaktohet nga monitorimi i vazhdueshëm i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.

3. Ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55 pika 6.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 3600 prot.

Vlorë, më 20.02.2026

RELACION

“PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE, PËR VITIN 2026 DHE TARIFËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT PËR ZONËN E PLAZHEVE, TË ADMINISTRUARA DHE TË TARIFUAR NGA NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE”

Të nderuar Këshilltar!

Po ju paraqesim këtë projektvendim “Për miratimin e hartës së përgjithshme të lejuar në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2026 dhe tarifës së shërbimit për zonën e plazheve publike të administruara dhe të tarifuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Baza ligjore:

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ i ndryshuar; Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, ligjit nr.93/2015”Për Turizmin” të ndryshuar; ligjit nr.8743, datë 22/02/2001, ”Për pronat e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, ligjit nr.9251, datë 08/07/2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 për miratimin e rregullores “Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit” i ndryshuar me vendimin nr.60 datë 28/01/2026.

Qëllimi i këtij projektvendimi:

Në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik për vitin 2026 në plazhet e Bregdetit të Vlorës si dhe në zbatimin dhe implementimin e Vendimit nr.649 datë 16.10.2024 Për Miratimin e Rregullores ”Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”, i ndryshuar, në ligjin 93/2015 ”Për Turizmin” parashikojnë kushte dhe kriteret të reja ligjore edhe për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, që kanë si qëllim parësor reflektimin e këtyre kërkesave të reja ligjore, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe standardeve për pushuesit nëpërmjet rritjes së nivelit të sigurisë në plazhe, shtimin e hapësirave të plazheve publike, vendosjen dhe

ruajtjen e kushteve higjienike si dhe mbrojtjen nga ndotjet dhe dëmtimet në plazhet pranë deteve.

Sipërfaqja totale e plazheve në hartën e propozuar nga Bashkia Vlorë në bregdetin e përfshirë brenda kësaj Bashkie i cili fillon nga Akërnja dhe përfundon tek porta e "Pashalimanit" në Orikum duke përfshirë këtë vit për herë të parë dhe një stacion plazhi në ishullin "Sazan", është 1 100 695 m² ose e shprehur në vijë lineare 22 000 m linear ose 22 km.

Stacionet e plazhit ndahen në 5(pesë) kategori "Të menaxhuara", "Publike", "Kontratë shumëvjeçare" "Investitor strategjik" dhe "Plazh publik i tarifuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore". Dy kategoritë e fundit shtohen këtë vit si zë i ri në tipologjinë e plazheve,sa i përket Bashkisë Vlorë.

- a) Tipologjia e plazheve "Të Menaxhuara" ka sipërfaqe 221 811 m² ose 20.1 % e sipërfaqes totale.
- b) Tipologjia e plazheve "Publike" ka sipërfaqe 832744 m² ose 75.7 % e sipërfaqes totale
- c) Tipologjia e plazheve "Kontratë Shumëvjeçare" ka sipërfaqe 25313 m² ose 2.3 % e sipërfaqes totale
- d) Tipologjia e plazheve "Plazh Publik i tarifuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore" ka sipërfaqe 18 176 m² ose 1.6 % e sipërfaqes totale
- e) Tipologjia e plazheve "Investitor Strategjik" ka sipërfaqe 2651 m² ose 0.03 % e sipërfaqes totale.

Harta e stacioneve të plazheve të cilat janë të shtrira në të gjithë vijën bregdetare është bazuar në kushtin e ndryshuar VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 për miratimin e rregullores "Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit" i ndryshuar me vendimin nr.60 datë 28/01/2026, ku subjektet private të cilat do të shfrytëzojnë stacionet e plazhit duhet të posedojnë hotele ose struktura akomoduese të kategorizuara nga Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sporteve me përjashtim të 2 zonave "Plazhit të Zvërnecit" dhe "Plazhit të Vjetër" në të cilat subjektet private mund të aplikojnë dhe ti shfrytëzojnë stacionet e plazheve vetëm me Bar - Restorant - "Beach Bar", por pa e tejkaluar maksimumin e çadrave 50 e përkthyer në sipërfaqe 600 m².

Referuar listës së dërguar nga kjo Ministri për strukturat e kategorizuara, Bashkia ka përgatitur hartën duke marrë në konsideratë dhe kriterin e ndarjes së sipërfaqes së plazhit të lejuar, sipas gjatësisë në vijë lineare, në mënyrë perpendikulare me vijën e bregut të detit, ku në çdo 1000 m vijë lineare 300 m vijë lineare plazh duhet të jetë publik dhe 700 m linear duhet të jetë i aplikueshëm për subjektet private.

Nga ana jonë ky raport është përmbushur duke i dhënë prioritet më tepër plazhit publik dhe publik të tarifuar duke u bazuar dhe në vijën e thyer bregdetare shkëmbore e cila është pothuajse e pashfrytëzueshme si nga publiku dhe nga subjektet private duke filluar nga zona tek "Kalaja" deri në "Jonufër".

Gjithashtu në hartën e plazheve janë paraqitur hapësirat e lejuara për notim të kufizuara me bova, 5 vendbazimet ujore të miratuara prej vitit 2022, në "Triport", "Portin e Vlorës"

2 venbazime të “Moli i Baçit” dhe “Porti i Jahteve” Orikum. Gjithashtu janë paraqitur 3 korridore ujore të miratuara prej vitit 2022 (VKB), 1 në Jonufër dhe 2 në Radhimë.

Referuar VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 për miratimin e rregullores “Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit” i ndryshuar me vendimin nr.60 datë 28/01/2026 është që sipërfaqet që janë përcaktuar edhe në hartën e plazheve, të sigurojnë një mirëadministrim të sipërfaqes publike por edhe monitorimin dhe sigurinë në plazhe.

Vlen të theksojmë se ky projekt vendim nuk përcakton një tarifë fikse, por duke ju referuar VKM-së së sipërcituar e cila përcakton edhe rregullat dhe mënyrën e menaxhimit të hapësirave publike, pra plazheve publike duke e ofruar këtë shërbim me një kosto më të ulët ndaj qytetarëve dhe me tarifa që qytetari është mësuar të hasi nga subjektet private. Kjo nismë konsiston edhe mbi faktin e ndryshimeve të fundit të VKM Nr.60 datë 28.01.2026 e cila shërben si një rregullator për tarifimin e hapësirës publike të tarifuar nga Nj.V.V.

Duke përcaktuar se tarifa e ofrimit të shërbimit në plazhe do të jetë deri në 50% të vlerës së tarifave në treg, vlera e tregut përcaktohet nga monitorimi i vazhdueshëm i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.

Qëllimi i Bashkisë është që këto tarifa të jenë më të ulta se sesa ato që ka tregu, pra që do të vijnë në ndihmë qytetarëve. Bashkia duke monitoruar dhe menaxhuar në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme plazhet publike në shërbim të pushuesve vendas apo dhe të huaj, do të disiplinojë edhe tregun, duke disiplinuar kështu edhe cmimet e vendosura nga subjektet private.

Vendosja e një tarife simbolike për përdorimin e hapësirës publike, normalisht do të krijoj të ardhura për institucionin e bashkisë, e cila do të shkojë për menaxhimin sa më të mirë të mundshëm të sezonit, për suksesin e sezonit turistik dhe zhvillimin e qytetit të Vlorës.


KRYETAR
Brunilda Mersini



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]







Plazhi i Vjetër

Stacionet e Plazhit sezoni turistik
2026



Legjenda

- | | |
|--------------------|--------------------------|
| Tipologjia | Koordinatat e Stacioneve |
| E MENAXHUAR | |
| INVESTITOR | Hapsira_Per_Notim |
| STRATEGJIK | Vendbazim_Ujor |
| KONTRATE | Koridore_ujore |
| PUBLIKE | |
| PUBLIKE E TARRTUAR | |
| NGA NDV | |

Geografi i Vjetër

Plazh i Vjetër

Plazh i Vjetër

VL-25

VL-27

VL-28

VL-6

VL-6/2

VL-29

VL-30

VL-6/3

VL-32

VL-34

VL-7/1

VL-7

VL-7/2

VL-7/3

VL-35


Plazh i Vjetër

Microsoft Vantor

Handwritten signature in blue ink.

Handwritten signature in blue ink.

Handwritten signature in blue ink.



Plazhi Lungomare

Stacionet e Plazhit sezoni turistik
2026



0 1 2 4 Kilometers

Legjenda

- | | |
|---------------------|--------------------------|
| Tipologjia | Koordinatat e Stacioneve |
| E MENAXHUAR | Hapsira_Per_Notim |
| INVESTITOR | Vendbrazim_Ujor |
| STRATEGJIK | Koridore_ujore |
| KONTRATE | |
| PUBLIKE | |
| PUBLIKE E TARRIFUAR | |
| NGA NJV | |

Plazhi Lungomare

Plazhi Lungomare

Plazhi Lungomare

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



Plazhi
Uji i
Ftohte - Jonufer

Plazhi Uji i Ftohtë

Stacionet e Plazhit sezoni turistik
2026




Legjenda

- | | |
|--|---|
| Tipologjia | Koordinatat e |
| E MENAXHUAR | Stacioneve |
| INVESTITOR | Hapsira_Per_Notim |
| STRATEGJIK | Vendbazim_Ujor |
| KONTRATE | Koridore_ujore |
| PUBLIKE | |
| PUBLIKE E TARTIPIUAR | |
| NGA NJV | |

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]


[Handwritten signature]





Plazhi Radhimë (1)

Stacionet e Plazhit sezoni turistik
2026



0 2.25 4.5 9 Kilometers

Legjenda


- | | |
|----------------------|---------------------------------|
| Tipologjia | Koordinatat e Stacioneve |
| ● E MENAXHUAR | ● Hapsira_Per_Notin |
| ● INVESTITOR | ● Vendbazim_Ujor |
| ● STRATEGJIK | ● Koridore_ujore |
| ● KONTRATE | |
| ● PUBLIKE | |
| ● PUBLIKE E TARRUJAR | |
| ● NGA NDV | |

Plazhi
Orkum 1

[Handwritten signature]


[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



Plazhi Radhimë (2)

Stacionet e Plazhit sezoni turistik
2026



Legjenda

- | | |
|-------------------|--------------------------|
| Tipologjia | Koordinatat e Stacioneve |
| E MENAXHUAR | |
| INVESTITOR | Hapsira_Per_Notim |
| STRATEGJIK | Vendbazim_Ujor |
| KONTRATE | Koridore_ujore |
| PUBLIKE | |
| PUBLIKE E TARRUAR | |
| NGA NJV | |

[Signature]

[Signature]

[Signature]



Plazhi Oriku (1)

Stacionet e Plazhit sezoni turistik
2026



Legjenda

- | | |
|---------------------|---------------------------------|
| Tipologjia | Koordinatat e Stacioneve |
| E MENAXHUAR | Hapsira_Per_Ndihm |
| INVESTITOR | Vendbazeim_Ujor |
| STRATEGJIK | Koridore_ujore |
| KONTRATE | |
| PUBLIKE | |
| PUBLIKE E TARRIFUAR | |
| NGA NJV | |

[Handwritten signature]


[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



Plazhi Orikum (2)

Stacionet e Plazhit sezoni turistik
2026



Legjenda


- | | |
|----------------------------|---------------------|
| ● Koordinatat e Stacioneve | — Hapsira_Per_Notim |
| ■ E MENAXHUAR | ■ Vendbazim_Ujor |
| ■ INVESTITOR STRATEGJIK | ■ Koridore_ujore |
| ■ KONTRATE | |
| ■ PUBLIKE | |
| ■ PUBLIKE E TARRFUAR | |
| ■ NGA NDV | |



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]